



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:186923

Datë: 19.10.2023

Numri i dokumentit: 04807060

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.803/23

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me bashkëpunëtoren profesionale Qendresa Sadrijaj, në çështjen penale kundër të pandehurit K. Z. për veprën penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par.2 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm nën shenjën PP/II.nr.2373/20 të datës 04.06.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 12.10.2023, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Dorian Juniku dhe të akuzuarit K.Z., të njëjtën ditë mori dhe shpalli ndërsa me datë 18.10.2023, përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

K. Z. , i lindur me dt.....në Istog, me banim në fsh.Z., Komuna Istog, rr.24 Qershori nr..., i biri I. dhe nënës S., e gjinisë S., ka të kryer shkollën fillore, i martuar-babë i tre fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, me lnj.nr....., Egjiptian, shtetas i R. se Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Me datën 12.12.2020 në kohë të pacaktuar, në fshatin Z., Komuna e Istogut, ka blerë sendin/pasurinë për të cilën ka mundur ta dijë se është e përfituar me vepër penale, në atë mënyrë që: pasi që të pandehurit tjerë vjedhin sendet si në dispozitivin 3 të lartëcekur, i pandehuri ka blerë nga i pandehuri B. B. sendet e lartcekura që janë përfituar me vepër penale, ku i blen shtylla

të metalit për mbajtje të plloçës së betonit, dërrasa dhe hekura të metalit, të gjitha në sasi prej 40-50 copë e në shumën prej 500,00 Euro, edhe pse ka mundur ta dijë se vlera e atyre sendeve në treg është me çmim më të lartë,

- me çka ka kryer veprën penale “Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale” nga Neni 333 par. 2 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

Të pandehurit K. Z. i shqipton:

- I. DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk do të kryej veprë tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, qe do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Obligohet i dënuari qe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

ARSYETIM

- A. Historiku i çështjes dhe vendimi në lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 04.06.2021, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2373/20 kundër të pandehurit K. Z. për veprën penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par.2 të KPRK-së.

Kjo gjykatë ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 07.06.2023, në çështjen penale nën shenjë P.nr. 452/22, në të cilën kanë qenë të akuzuar F. L., L. N., J. F., A. F., N. J., B. D., A. S. dhe këtu i pandehuri K. Z., i cili para gjyqtarit paraprak i cili ishte bartës i kësaj lënde në

procesverbalin e datë 08.07.2021, kishte pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë, ku pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit gjykata kishte aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike. Në seancën e mbajtur me datë 07.06.2023, gjyqtari i vetëm gjykues pasi mori mendimin e Prokurorit të Shtetit dhe të dëmtuarit për veçimin e procedurës ndaj të pandehurit K.me Aktvendim procedural në procesverbal ka veçuar procedurën penale ndaj të pandehurit K. Z. e cila do të zhvillohej nën numër të ri përkatës të lëndës. Pas marrjes së vendimit për veçim të procedurës për këtu të pandehurin K. Z., është caktuar seanca për caktimin e dënimit me datë 12.10.2023, e cila u mbajt në prezencë të prokurorit të shtetit Dorjan Juniku dhe të pandehurit K.Z..

Ne lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit prokurori i shtetit deklaroi: “duke marrë parasysh se i akuzuari e pranoi fajësinë konform kushteve ligjore të parapara me nenin 242 të KPPRK-së, të cilin pranim e ka deklaruar në bazë të vullnetit të lirë, pa ndikim dhe referuar të gjitha fakteve në të cilat mbështet kjo aktakuzë nga Gjykata kërkoj që të njëjtin t’ a shpallë fajtor, t’ a dënoj sipas ligjit si dhe t’ a obligoj në pagesën e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa në rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit pranimin e fajësisë t’ a vlerësoj si rrethanë lehtësuese”.

Pas aprovimit të pranimi të fajësisë nga ana e gjykatës, i pandehuri K. Z. deklaroi: “ më vjen keq që ka ndodhur ky rast, nuk e kam dit se çka është puna e këtyre shtyllave, personi që m’ i ka shitë e kam komshi dhe më ka thënë se i kam të një familjari kinse ai është prish me mjeshër dhe mjeshtri i ka mbet borxh atij e aty ja ka shit materialin, andaj më vjen shumë keq. Gjithashtu, ju njoftoj se materiali që e kam ble ju ka kthye personit të cilit ju ka vjedhur. Jam i penduar shumë për këtë rast”.

B. Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të çështjes.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin nuk ka rrethana rënduese që parashihen në nenin 70 par.2 të KPRK-së, ndërsa si rrethana lehtësuese e bazuar në nenin 70 par.3 pika 3.10 të KPRK-së, gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar i cili pranim fajësie shoqërohet me keqardhje nga i pandehuri dhe deklarim se sendet tashmë i janë kthyer pronarit nga i cili janë vjedhur, andaj duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 e 48 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehurit ligjvënësi ka paraparë që për këtë veprë penale të shqiptohet dënimi me burgim deri në një (1) vit, e në këtë rast gjykata pas analizimit, shqyrtimit dhe vlerësimit të të gjitha rrethanave ka vendosur që të akuzuarit t' i shqiptojë dënim me burg të kushtëzuar prej gjashtë (6) muaj nëse brenda periudhës kohore të verifikimit prej një (1) viti nuk kryen veprë tjetër penale. Përkitazi me këtë dënim të shqiptuar gjykata u bazua në nenin 49 par.1 në lidhje me kushtet për shqiptimin e dënimit me kusht, ku parashihet që dënimi me kushte shqiptohet për vepra penale të dënueshme deri në pesë (5) vite burgim, e duke pasur parasysh se vepra penale që i vihet në barrë të akuzuarit dënohet me burgim deri në 1 vit, përderisa kushti apo periudha e verifikimit prej një (1) viti i është llogaritur ashtu siç parashihet me nenin 48 par.2 të KPRK-së, ku thuhet se: "... koha e verifikimit nuk mund të jetë më e shkurtër se një (1) vit e as më e gjatë se pesë (5) vite".

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit K. Z. është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale te ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjorë nga neni 364 dhe 369 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal
P.nr.803/23, me datë 18.10.2023

Bashkëpunëtorja profesionale:
Qendresa Sadrijaj

Gjyqtari i vetëm gjykues:
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.